



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 1 Mars 2022

Nr: 2

UDHËZIM

PËR

**PËRDORIMIN E APLIKACIONIT “KQZ”, NË ZGJEDHJET E PJESSHME PËR
KRYETAR BASHKIE, TË DATËS 6 MARS 2022**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1 shkronjat “b”, “h” e “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenit 38, pika 5, të vendimit nr. 11, datë 25.3.2021, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e ngritjes, organizimit dhe funksionimit, të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimit” të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

UDHËZON:

1. Përdorimin e programit aplikativ “KQZ” nga anëtarët e KQV-ve, KZAZ-ve dhe operatorët e KQZ-së, të ngarkuar me detyra të posaçme në qendrat e votimit, sipas procedurave të përcaktuara në lidhjen nr 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.
2. Përdorimi i aplikacionit “KQZ” nuk i përjashton anëtarët e KQV-ve ose të KZAZ-ve nga detyrimi për përdorimin dhe mbajtjen e çdo dokumentacioni tjetër zgjedhor, si të tilla, por pa u kufizuar, libri i protokollit të mbledhjeve, vendime, procesverbale, etj.
3. Nëpërmjet aplikacionit “KQZ”, anëtarët e KQV-ve ose të KZAZ-ve, si dhe sipas rastit, operatorët, informojnë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve duke raportuar për dorëzimin e bazës materiale, vendimmarrjeve të tyre, ecurinë e votimit dhe/ose të numërimit e të nxjerrjes së rezultatit.
4. Operatori i PEI dërgon çdo 1 (një) orë, duke filluar nga ora 7:00 e ditës së votimit, informacionin mbi pjesëmarrjen nëpërmjet “Skano QR Code”, sipas procedurave të përcaktuara në lidhjen nr. 1. Ky informacion mund të dërgohet në KQZ edhe nga secili



prej anëtarëve të KQV-ve, por në çdo rast pa penguar procesin e votimit dhe përdorimin e PEI nga operatori.

5. Ngarkohen anëtarët e Komisioneve të Qendrave të Votimit, të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor dhe operatorët e KQZ-së, të ngarkuar me detyra të posaçme në qendrat e votimit, për zbatimin e këtij udhëzimi.
6. Udhëzimi nr. 9, datë 15.4.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përdorimin e aplikacionit “KQZ” shfuqizohet.
7. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI




Lidhja 1: PROCEDURA E PERDORIMIT TE APLKACIONIT “KQZ” NGA KQV DHE KZAZ




Data: 1 Mars 2022
Nr. 2

“Për përdorimin e aplikacionit “KQZ” në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

1. Komisionerët e Qendrave të Votimit (KQV), Komisionerët e Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), Sekretarët dhe Operatorët mund të aksesojnë rubrikën e dedikuar të përdoruesve të identifikuar nëpërmjet klikimit në menunë përkatëse (ilustrim më poshtë).



2. Pasi ka klikuar “Hyr si KQV/KZAZ/Operator”, përdoruesi (komisioner/operator/sekretar) do t’i shfaqen dy menu login-i, ku njëra do të jetë për aksesimin e KQV operator/komisioner, ndërsa tjetra do të jetë për aksesimin e KZAZ komisioner/sekretar (ilustrim më poshtë).




- 2.1 Nëse klikon në menunë e parë, “Hyr si KQV/Operator” përdoruesi komisioner/ operator/ sekretar) duhet të aktivizojë llogarinë e tij, duke vendosur numrin e tij të celularit dhe fjalëkalimin. Fjalëkalimi dërgohet me “sms” (mesazh) nga KQZ, të paktën 1 ditë para ditës së votimit.

Në fushën e parë duhet të vendoset numri i celularit.


Në fushën e dytë duhet të vendoset fjalëkalimi (kodi i dërguar me sms)

Më pas klikohet në butonin “HYR” (ilustrim më poshtë).




Në rast paqartësie mbi mënyrën e përdorimit, mund të aksesojë rubrikat e ndihmës:

- Kërko Ndihmë
- Manuali i Komisionerit
- Manuali i Pajisjes (Operatorët)



2.2 Nëse klikon në menunë e dytë, “Hyr si KZAZ” përdoruesi (komisioner/sekretar) duhet të aktivizojë llogarinë e tij, duke vendosur adresën e tij të email-it dhe fjalëkalimin. Mund të ruajë llogarinë e tij duke klikuar në opsionin, “Më mbaj mend”. Më pas klikohet në butonin “Identifikohu” (ilustrim më poshtë).



3. Nëse procesi është realizuar me sukses për menunë e parë të aksesimit si KQV (komisioner/operator/sekretar), përdoruesi do të ketë mundësinë për të aksesuar rubrikat e mëposhtme sipas rolit:

- Raporto Hapje/Mbyllje të Procesit (Komisionerët)
- Raporto Ecurinë Gjatë Ditës (Komisionerët)
- Manuali i Përdorimit
- Skano QR Code (Operatorët)
- Dil nga Sistemi


Hapësira e Komisionerit

4. Raporto Hapje/Mbyllje të Proçesit

Nëpërmjet këtij funksioni, komisioneri mund të raportojë në kohë reale për hapjen ose mbylljen e procesit në Qendrën e Votimit duke klikuar në rubrikën “Raporto Hapje/Mbyllje të Proçesit” (ilustrim me poshtë):



5. Më pas komisionerit do t'i shfaqet një faqe e re, ku mund të zgjidhë statusin *Hapur/ Pezulluar/ Mbyllur* duke klikuar tek njëri nga statutet dhe të shtojë informacione plotësuese sipas rëndësisë (ilustrim me poshtë):



6. Nëse përdoruesi do të zgjedhë një nga statutet *Hapur/Pezulluar/Mbyllur*, do të shfaqen kërkesat e nevojshme për secilën nga statutet në varësi të kërkesës së përdoruesit (ilustrim më poshtë).

< Back Raporto Hapjen/Mbylljen e QV



Keni marrë vendim për hapjen e votimit në orën 7:00?

- Po
 Jo

Shëno më shumë

Dërgo

< Back Raporto Hapjen/Mbylljen e QV



Keni marrë vendim për pezullimin e votimit?

- Po
 Jo

Shëno më shumë

Dërgo

< Back Raporto Hapjen/Mbylljen e QV




Keni marrë vendim për mbylljen e votimit në orën 19:00?

- Po
 Jo

Shëno më shumë

Dërgo

7. Në përfundim të raportimit, komisioneri duhet të klikojë “Dërgo”, dhe do t’i shfaqet një mesazh suksesi në lidhje me raportimin e kryer (ilustrim më poshtë):



8. Raporto Ecurinë Gjatë Ditës


Nëpërmjet këtij funksioni, komisioneri mund të raportojë në kohë reale për ecurinë e zgjedhjeve gjatë ditës, duke klikuar në rubrikën “Raporto Ecurinë Gjatë Ditës” (ilustrim me poshtë):



9. Më pas, komisionerit do t'i shfaqet një faqe e re, ku mund të zgjidhë statusin e situatës në QV ose KZAZ, *Normale/ e Tensionuar/ e Pezulluar* duke klikuar tek fusha e parë “Raporto Ecurinë Gjatë Ditës” dhe të shtojë informacione plotësuese sipas rëndësisë (ilustrim më poshtë):

10. Komisioneri mund të vendosë një shënim, nëse zgjedh të raportojë për ecurinë si “Normale”, “E Tensionuar” ose “E pezulluar”. Gjithashtu komisioneri duhet të vendosë orën e saktë të raportimit. Nëse nuk vendos orën, raportimi nuk mund të dërgohet. (ilustrim më poshtë).

11. Në përfundim të raportimit, komisioneri duhet të klikojë “Dërgo”, dhe do t'i shfaqet një mesazh suksesi në lidhje me raportimin e kryer (ilustrim me poshtë):




Hapësira e Operatorit

12. Skano “QR Code”

Opsioni për të skanuar dhe dërguar një “QR Code” është funksion i dedikuar vetëm për “Operatorin” (ilustrim me poshtë).



13. Pas navigimit në rubrikën “Skano QR Code”, operatori do të drejtohet në faqen pasardhëse, ku në klikim të butonit “Skano”, në aparatit celular do të hapet kamera e cila do të fokusojë kodin me një vijë të kuqe në mes (ilustrim me poshtë).




Kujdes: Duhet që vija e kuqe në kamerën e celularit, të jetë e fokusuar në mes të “QR Code”!

14. Pas skanimit të “QR Code”, të dhënat do të dërgohen automatikisht në sistem pasi operatori të shtyp “Mbyll”. Sistemi do të përditësojë të dhënat për numrin e zgjedhësve që kanë votuar në një QV duke i kategorizuar në femra dhe meshkuj (ilustrim me poshtë).

Operatori mund të klikojë “Mbyll”, për t’u larguar nga kjo tabelë me të dhëna.
Për të vijuar me skanimin e një “QR Code” tjetër, do të ndiqet e njëjta procedurë.

15. Nëse procesi është realizuar me sukses për menunë e dytë të aksesimit si KZAZ (komisioner/ sekretar), përdoruesi do të ketë mundësinë për të aksesuar rubrikat e mëposhtme sipas rolit:


- Raportimi Përpara Ditës së Votimit
- Raportimi në Ditën e Votimit
- Raportimi Pas Mbylljes së Votimit deri në Shpalljen e Rezultatit (ilustrim më poshtë).



16. Në “Raportimin Përpara Ditës së Votimit”, përdoruesit do t’i shfaqen raportet dhe kërkesat në lidhje me anëtarët e KQV/GNV, dhe do të ketë mundësi të përditësojë raportin, duke klikuar në butonin “Përditëso raportin” (ilustrim më poshtë).



17.Pasi përdoruesi klikon në butonin “Përditëso raportin”, do t’i shfaqen të dhënat e “Raportimi Përpara Ditës së Votimit” dhe përdoruesi do të ketë të drejtë të modifikojë këtë raport (ilustrim më poshtë).



Pasi përdoruesi ka bërë modifikimet e tij në raportin e dhënë, në fund të faqes duhet të klikojë butonin “Ruaj ndryshimet” për ta ruajtur këtë raport të ndryshuar, ose mund të klikojë në butonin “Anullo” për të mos ruajtur asnjë nga ndryshimet e bëra në raport.

18. Në “Raportimi në Ditën e Votimit” përdoruesi do të shikojë sesi është situata ditën e votimit në lidhje me të gjitha QV në KZAZ-të përkatëse, dhe dinamikën e pjesëmarrjes për të gjithë QV në KZAZ-të përkatëse. Përdoruesi do të ketë mundësi që nëpërmjet butonit “Përditëso raportin” të modifikojë raportin e dhënë (ilustrim më poshtë).

The screenshot shows a mobile application interface for reporting on election day. At the top, there are navigation options: '< Back' and 'Hyr si KZAZ'. Below this is the title 'RAPORTIM NË DITËN E VOTIMIT' and a breadcrumb trail 'Home > RAPORTIM NË DITËN E VOTIMIT'. The main content is a table with 12 rows, each representing a different report category and its count. At the bottom of the table is a green button labeled 'Përditëso raportin'.

Raportimi	Numri
Raporto sa QV ne KZAZ-ne tuaj janë hapur ne ora 7	4
Raporto sa QV ne KZAZ-ne tuaj janë te hapura me vonese (pas ores 7)	4
Raporto sa QV ne KZAZ-ne tuaj te cilat kane pezulluar votimin	4
Raporto sa QV ne KZAZ-ne tuaj te pezulluara per shkak te mosfuzionimit te PEI	4
Raporto sa QV ne KZAZ-ne tuaj te cilat funksionojne pa PEI per shkak te mungeses se operatoreve/ mosfuzionimit te PEI	4
Raporto sa QV ne KZAZ-ne tuaj te cilat nuk funksionojne kamerat	0
Raporto pjesmarrjen per te gjithe QV ne KZAZ-ne tuaj (dinamike)	4
Raporto sa QV janë mbyllur ne ora 19:00	9
Raporto sa QV janë mbyllur pas ores 19:30	8
Shëno QV (numrin e qv që nuk kanë dorëzuar materialet e votimit)	7
Shëno QV (numrin e qv që nuk kanë dorëzuar materialet e votimit)	6

Pasi përdoruesi ka bërë ndryshimet e tij në raportin e ditës së votimit, në fund të faqes mund të klikojë në butonin “Ruaj ndryshimet” për të ruajtur ndryshimet e bëra, ose mund të klikojë në butonin “Anullo” për të mos ruajtur asnjë ndryshim të bërë (ilustrim më poshtë).

< Back Hyr si KZAZ

KQZ Portali

Modifiko raportimin per ditën e votimit

ZAZ 8

Raporto sa QV ne KZAZ-ne tuaj janë hapur ne ora 7

4

Raporto sa QV ne KZAZ-ne tuaj janë te hapura me vonese (pas ores 7)

4

Raporto sa QV ne KZAZ-ne tuaj te cilat kane pezulluar votimin

4

Raporto sa QV ne KZAZ-ne tuaj te pezulluara per shkak te mosfunksionimit te PEI

4

Raporto sa QV ne KZAZ-ne tuaj te cilat funksionojne pa PEI per shkak te mungeses se operatoreve/ mosfunksionimit te PEI

4

Raporto sa QV ne KZAZ-ne tuaj te cilat nuk funksionojne kamerat

0

19. Në “Raportimi Pas Mbylljes së Votimit deri në Shpalljen e Rezultatit”, përdoruesi do të shikojë raportin e QV të numëruara/tabeluara/pa numëruara; raportim nëse është pezulluar ose jo procesi, dhe arsyet e pezullimit në rast pezullimi (ilustrim më poshtë).

Përdoruesi mund të klikojë ne butonin “Përditëso raportin”, ku do t’i shfaqen te raportimet mbas mbylljes se votimeve. Në fund te faqes do t’i shfaqet një buton “Ruaj raportin” për të ruajtur ndryshimet e bëra në këtë raport, ose mund të klikojë në butonin “Anullo” për të mos ruajtur asnjë ndryshim të bërë (ilustrim më poshtë).

16:43
📶 🔋

< Back
Hyr si KZAZ

☰
👤

Modifiko raportimin pas mbylljes se votimeve

ZAZ 8

Raporto sa QV janë numeruara/ tabeluara

Raporto sa GN po numerojne

Raporto sa QV kanë mbetur pa u numëruar

Raporto sa tabela përmbledhëse jane kontestuar nga vëzhguesit

Raporto nese eshte pezulluar procesi

Shëno Arsytet e pezullimit

Ruaj raportin
Anullo

< Back
Hyr si KZAZ
☰
👤
Përditeso raportin

20. Përdoruesi mund të klikojë “Mbrapa”, për t’u larguar nga kjo faqe me të dhëna.

